



Mapu staze, broshure i više informacija o Vrhovima Balkana, možete dobiti u info centru Turističke organizacije u Plavu, i info centru NP Prokletije, a preko njih možete obezbijediti smještaj, vodiča ili prevoz do mjesta sa kojeg želite početi svoje planinarenje.



Hartën e shtegut, broshura dhe informacione më të hollësishtme për „Peaks of the Balkans” mund t’i merrni në qendrën informative të Organizatës Turistike në Plavë dhe në qendrën informative të Parkut Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna. Përmes tyre mund të siguronit akomodim, udhërrëfyes apo transport deri në vendin nga ku dëshironi të filloni ecjen tuaj malore.

MONTENEGRO



Peaks of the Balkans Medjunarodna Planinarska staza



Staza Peaks of the Balkans je medjunarodna planiraska staza koja prolazi kroz planinska područja Crne Gore, Albanije i Kosova. Stazu su osmislile nacionalne i lokalne turističke organizacije i planinarski klubovi u saradnji sa GIZ-om.

Staza Peaks of the Balkans je 192 km duga, prolazi kroz netaknute i divlje predjele Prokletijskog lanca kroz tri države, Crne Gore, Albanije i Kosova. Ovo je jedna od najboljih i najljepših planinarskih staza u Evropi. Uzdiže se i na preko 2.300 metara nadmorske visine, zalazi u najljepša sela, doline, jezera od kojih zastaje dah. Ovaj region je do prije nekoliko godina bio skoro nedostupan planinarima, samo su rijetki i uporni znali njegove tajne, a sada je dostupna svakom zaljubljeniku čiste prirode, i očuvane autentičnosti.

Da bi se obišla kompletna staza potrebno je od 10-13 dana, što zavisi od spremnosti planinara. Može se početi u bilo kojoj od ove tri zemlje, odnosno u Plavu – Crna Gora, Thethiju – Albanija, Peći - Kosovo. Ukoliko niste odlučni da prepješačite kompletnu stazu, onda možete da uz pomoć planinarskog vodiča obidete neki njen dio, koji vas najviše privlači.

Staza je u potpunosti markirana, tako da se ne može desiti da se zagubite. Kroz Crnu Goru prolazi jedna trećina staze, opštine Plav i Gusinje. Može se reći da je to i najljepši dio Peaks of the Balkans staze. Planinarenjem kroz Prokletije u prilici ste vidjeti Plavsko i Hridsko jezero, prelijepu dolinu Ropojane i Ropojansko jezero, Babinopoljsku dolinu, mnoštvo sela, katuna i nekoliko planinarskih domova, u kojima ste uvijek dobrodošli. Dobrodošli ste i u centru za posjetioce Nacionalnog Parka Prokletije, đe više možete saznati o flori i fauni Prokletija, kupiti neki od suvenira iz ovog kraja. Kultura i tradicija Plava i Gusinja će vas takođe oduševiti, brojne su džamije, crkve i kule.

Shtegu Peaks of the Balkans është një shteg ndërkombëtare malorë që kalon përmes zonave malore të Malit të Zi, Shqipërisë dhe Kosovës. Shtegu është konceptuar nga organizatat turistike kombëtare dhe lokale si dhe nga klubet alpiniste, në bashkëpunim me GIZ-in.

Shtegu „Peaks of the Balkans” është i gjatë 192 km, dhe kalon nëpër peizazhe të egra dhe të paprekura të vargmalit të Bjeshkëve të Nemuna në tri shtete – Malin e Zi, Shqipërinë dhe Kosovën. Kjo është njëra nga shtigjet më të bukura dhe më të mira për ecje malore në Evropë. Ngjitet mbi 2.300 metra mbi nivelin e detit, kalon nëpër fshatra piktoreske, lugina dhe liqene që të lënë pa frymë. Ky rajon, deri para disa vitesh, ishte pothuajse i paarritshëm për alpinistët – vetëm të rrallët dhe këmbëngulësit i dinin sekretet e tij. Sot është i hapur për çdo adhurues të natyrës së pastër dhe autenticitetit të ruajtur.

Për të vizituar të gjithë shtegun duhen 10 deri në 13 ditë, varësisht nga përgatitja fizike e alpinistit. Mund të fillohet nga cilido prej tre vendeve – nga Plava - Mali i Zi, Thethi - Shqipëri, Peja - Kosovë. Nëse nuk jeni të vendosur të ecni të gjithë shtegun, atëherë me ndihmën e një udhërrëfyese malor mund të vizitoni pjesën që ju tërheq më shumë.

Shtegu është tërësisht i shënuar, kështu që është e pamundur të humbni rrugën. Një e treta e shtegut kalon



përmes Malit të Zi, më saktësisht në komunat Plavë dhe Guci, që mund të quhet edhe pjesa më e bukur e shtegut e „Peaks of the Balkans”. Gjatë ecjes nëpër Bjeshkët e Nemuna keni mundësi të shihni Liqenin e Plavës dhe të Hridit, luginën e bukur të Ropojanës dhe liqenin e saj, luginën e Babinopoles, shumë fshatra, katune dhe disa shtëpi malore ku jeni gjithmonë të mirëpritur. Të mirëpritur jeni edhe në qendrën për vizitorë të Parkut Kombëtar të Bjeshkëve të Nemuna, ku mund të mësoni më shumë për florën dhe faunën e Bjeshkëve të Nemuna, apo të blini ndonjë suvenir nga ky rajon. Kultura dhe tradita e Plavës dhe Gucisë do t’ju mahnisin gjithashtu – ka shumë xhami, kisha dhe kulla historike.

